

Trajtimi i lëndëve të korrupsionit në dekadën e fundit në Kosovë, ndikimi i ndryshimeve legislative

Trajtimi i lëndëve të korrupsionit në dekadën e fundit në Kosovë, ndikimi i ndryshimeve legjislative

TITULLI:

Trajtimi i lëndëve të korrupsionit në dekadën e fundit në Kosovë, ndikimi i ndryshimeve legjislative

AUTOR:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

2025

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Tringë Smajli, H6/5, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Ky raport u realizua nga Lëvizja FOL dhe Prishtina Institute for Political Studies (PIPS), me mbështetje nga programi MATRA i Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë. Pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë.

Të drejtat e autorit © 2025. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	7
Pjesa I: Periudha 2015 – 2019	9
Korniza organizative	10
Korniza ligjore.....	12
Kodi penal nr. 04/L-082 dhe kodi i procedurës penale 04/L-123	12
Trajnimet për forcimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit	15
Performanca e sistemit prokurorial.....	18
Performanca e sistemit gjyqësor	21
Konkluzion i periudhës 2015 – 2019	25
Pjesa II: periudha 2020 – 2024.....	27
Korniza organizative.....	28
Korniza ligjore	30
Kodi penal nr. 06/l-074 dhe kodi i procedurës penale nr. 08/l-032	30
Udhëzues i veçantë i Gjykatës Supreme: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.....	33
Trajnimet për forcimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit	36
Performanca e sistemit prokurorial	38
Performanca e sistemit gjyqësor	40
Konkluzione.....	30
Rekomandimet	31

Përmbledhje ekzekutive

Kosova mbetet ende e cënueshme nga korrupsioni, edhe pse prej më shumë se dy dekada ka marrë mbështetje të gjerë nga partnerët ndërkombëtarë për të forcuar sistemin e drejtësisë dhe për të rritur llogaridhënien publike

Lëvizja FOL përmes kësaj analize ka bërë vlerësimin e ndryshimeve legjislative dhe strukturën organizative (institucionale) në raport me efektivitetin dhe ndikimin e këtyre nismave në luftën kundër korrupsionit, duke vlerësuar nëse ndryshimet në kuadrin ligjor dhe aktivitetet tjera të organeve të drejtësisë përfshirë edhe aktivitetet e trajnimit kanë kontribuar pozitivisht në uljen e korrupsionit në Kosovë.

Ky raport analizon periudhën e dhjetë viteve të fundit, përkatësisht nga viti 2015 deri në 2024, në dy blloqe kohore – 2015-2019 dhe 2020-2024, duke tentuar të identifikojë se sa kanë ndikuar reformimi ligjor, investimet institucionale dhe programet e trajnimit në uljen e korrupsionit, respektivisht a kanë pasur ose jo efekt pozitiv në trajtimin e rasteve të korrupsionit.

Në pesëvjeçarin e parë, kompetencat e paqarta mes PSRK dhe prokurorive themelore krijuan mbivendosje hetimesh, ndërsa gjykatat, pa një departament të dedikuar, mbyllnin më pak se 40 % të çështjeve në vit. Trajnimet ishin të shumta por nuk sollën rritje të matshme të cilësisë së hetimeve. Nga viti 2020 nis një qasje më e strukturuar: themelohet Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës, miratohet Kodi i ri Penal me dënime më të ashpra dhe, shumë me rëndësi, Gjykata Supreme miraton Udhëzuesin specifik për lëndët e korrupsionit që synon unifikimin e politikës ndëshkimore. PSRK ruan efikasitet të lartë, veçanërisht më 2024, por prokuroritë e rregullta, sidomos ajo e Prishtinës, vazhdojnë të përballen me ngarkesë të madhe dhe variabilitet në rezultatet përfundimtare. Në anën gjyqësore, departamenti i ri ka hapur rrugë për trajtim më të fokusuar të rasteve komplekse, megjithëse raportimi statistikor 2022-2024 mbetet i pa unifikuar dhe pengon një vlerësim të qartë të progresit real.

Si rrjedhojë, Raporti është i ndarë në dy pjesë kryesore:

- **PJESA 1** përshkruan kuadrin ligjor dhe performancën e sistemit gjyqësor në Kosovë për periudhën 2015-2019, kur ishin në fuqi Kodi Penal Nr. 04/L-082 dhe legjislacioni tjerët përkatës si dhe bën analizimin e të dhënave statistikore të sistemit prokurorial dhe gjyqësor, kurse
- **PJESA 2** e cila mbulon periudhën nga viti 2020 deri në 2024, një vit pasi që ka hyrë në fuqi Kodi i ri Penal NR. 06/L-074.

Arsyeja pse merret viti 2020 është sepse organeve të drejtësisë i duhen së paku një vit të zbatimit të legjislacionit të ri për të parë eventualisht efektet pozitive të këtyre ndryshimeve. Raporti përmbillet me gjetjet dhe rekomandimet kryesore.

Lëvizja FOL dëshiron të shprehë mirënjohje të veçantë për Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial dhe Akademinë e Drejtësisë, të cilët pa asnjë hezitim dhe pa vonesa kanë përcjellë të gjitha të dhënat e kërkuara për realizimin e këtij raporti. Megjithatë dëshirojmë të theksojmë një observim të vogël sa i përket të dhënave nga Këshilli Gjyqësor, pasi ka qenë shumë e vështirë të analizohen dhe krahasohen të dhënat e viteve 2022 dhe 2023 pasi që nuk kanë përfshirë informacione rreth dënimeve të shqiptuara.

A vertical red line runs down the left side of the page, featuring five red circular dots of varying sizes. The largest dot is at the top, followed by three smaller dots, and a medium-sized dot at the bottom. A horizontal red line segment connects the bottom dot to the left edge of the page.

2015

Pjesa 1:
Periudha
2015 – 2019

2019

Korniza organizative

Gjatë kësaj periudhe sistemi prokurorial ka qenë i organizuar në përputhje me Ligjin për Prokurorin e Shtetit¹ dhe Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës,² që ka paraparë që në Kosovë të jenë shtatë (7) Prokurori Themelore me kompetencë territoriale në rrafshin regjional për çështjet e korrupsionit, si dhe Prokurori Speciale (PSRK) që ka kompetencë territoriale për tërë Republikën e Kosovës në çështjet e korrupsionit si kompetencë plotësuese.

Megjithatë, për shkak të mungesës së një kufiri të qartë ligjor ndërmjet këtyre institucioneve (PSRK dhe prokurorive tjera themelore), ka pasur mbivendosje të përsëritura në menaxhimin e lëndëve, pavarësisht se në nëntor të vitit 2013, ish-Kryeprokurori i Shtetit, z. Ismet Kabashi, ish-Kryeprokurorja e EULEX Jaroslava Novotna dhe ish-Kryeprokurori i PSRK, z. Jonathan Ratel, kanë nënshkruar Udhëzuesin për Rastet e Profilit të Lartë të Korrupsionit³ për t'i eliminuar këto mbivendosje ndërmjet zyrave të ndryshme prokuroriale.

Sa i përket sistemit gjyqësor, sipas Ligjit për Gjykatat,⁴ gjykatat kanë qenë të organizuara në shtatë (7) Gjykata Themelore dhe 20 degë gjyqësore. Rastet e korrupsionit janë trajtuar vetëm nga Gjykatat Themelore, pasi degët nuk kanë pasur departamente për krime të rënda. Kjo sepse rastet e korrupsionit janë trajtuar nga departamentet për krime të rënda në prokuroritë themelore dhe në gjykatat themelore, pasi që Kodi i Procedurës Penale ka paraparë që rastet e korrupsionit të trajtohen si krime të rënda, pa ndonjë shkallëzim të mëtejshëm në raport me dëmin apo nivelin e fajësisë.

Ajo që është karakteristike për këtë periudhë është se në gjykata nuk ka pasur ndonjë instancë gjyqësore të veçantë që do të kishte kompetencë ekskluzive për çështjet e PSRK.


1 [Ligji Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit](#), i shfuqizuar

2 [Ligji Nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës](#), i shfuqizuar

3 Udhëzuesi për Rastet e Profilit të Lartë të Korrupsionit, 2013, [A.-190-2013-Udhezim-Veprat-E-Korrupsionit-Te-Nivelit-Te-Larte.Pdf](#)

4 [Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat](#), i shfuqizuar

Strukture organizative e sistemit prokurorial dhe gjyqësor



Korniza ligjore

Kodi Penal nr. 04/L-082 dhe Kodi i Procedurës Penale 04/L-123

Nenet 422 deri 437 të Kodit Penal të Kosovës⁵ përbejnë shtyllën kryesore penale mbi bazën e së cilës ndërmerren ndjekjet penale dhe gjykimet e personave të akuzuar për korrupsion. Këto nene trajtojnë një gamë të gjerë të veprave që lidhen me keqpërdorimin zyrtar, korrupsionin klasik, mosraportimin e pasurisë dhe falsifikimin e dokumenteve zyrtare dhe veprat të tjera të natyrës korruptive.

Dënimet variojnë nga gjoba për rastet më të lehta, deri në dymbëdhjetë (12) vjet burgim për rastet më të rënda, siç janë ato me pasoja të mëdha ose me përfitim të madh material.

Neni më i përdorur në praktikën gjyqësore është ai për keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar. Ky nen mbulon situatat kur zyrtari publik, qëllimisht, shkel ligjin për të nxjerrë përfitim për vete ose për persona të tjerë, ose për të shkaktuar dëm të tjerëve. Dënimet për këtë vepër fillojnë nga 6 muaj deri në 5 vjet burgim. Ky nen është përdorur nga prokurorët si "bazë" për një numër të madh të rasteve penale, sidomos në sektorin e prokurimit publik apo administratës.

Një nga nenet më klasike të korrupsionit mbetet ai për marrjen e ryshfetit. Në rastin bazë, parashihet gjobë ose burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet, ndërsa nëse ryshfeti është marr për vepruar në kundërshtim me detyrat zyrtare, dënimi arrin deri në 12 vjet. Edhe dhënia e ryshfetit parashihet në mënyrë të ngjashme, dhe këto dy nene së bashku përbëjnë boshtin e hetimeve për korrupsion të pastër zyrtar.

Po ashtu, përvetësimi në detyrë është një nen i veçantë që sanksionon zyrtarin i cili përvetëson pasurinë që i është besuar në funksionin zyrtar. Dënimi është gjobë dhe burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet, ndërsa për përvetësim mbi 5,000 euro ose kur pasojat janë të rënda, dënimi rritet deri në 8 vjet. Për vlera të mëdha ose pasoja veçanërisht të rënda (mbi 50,000 euro), parashihet deri në 12 vjet burgim. Në praktikë, këto vepra janë hasur sidomos në administrimin e mjeteve të ndërmarrjeve publike apo institucioneve të tjera shtetërore.

Konflikti i interesit përbën një nga veprat penale më sfiduese për zbatimin praktik. Ai sanksionon rastet kur zyrtari merr pjesë në vendimmarrje apo veprime zyrtare ku ka interes personal ose lidhje familjare. Dënimi është gjobë ose burgim deri në 3 vjet, por në praktikë, për shkak të vështirësisë për të dëshmuar lidhjen konkrete të interesit me vendimmarrjen, pak raste përfundojnë me dënim efektiv.

5 [Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës Së Kosovës](#), i shfuqizuar,

Në fund, neni 437, i cili ka të bëjë me mosraportimin ose raportimin e rremë të pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, ka marrë rëndësi të veçantë viteve të fundit. Ky nen është thelbësor për transparencën në deklarimin e pasurisë nga zyrtarët publikë. Dënimi është gjobë ose burgim deri në 5 vjet, duke reflektuar seriozitetin e shkeljes së detyrimeve për deklarim të saktë të pasurisë.

Tabela më poshtë jep më në detaje shtrirjen e dënimeve për secilën vepër penale nga Kapitulli XXXIV – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare:

Neni	Emërtimi i plotë	Dënimi sipas par. 1	Dënimi sipas par. 2	Dënimi sipas par. 3	Dënimi sipas par. 4	Dënimi sipas par. 5
422	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	Burgim prej 6 muaj deri 5 vjet				
423	Keqpërdorimi i informatës zyrtare	Gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.	Gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet	Gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.	Gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.	
424	Konflikti i interesit	Gjobë ose burgim prej 6 muaj deri 5 vjet	Burgim prej 1 deri 5 vjet			
425	Përvetësimi në detyrë	Gjobë dhe burgim prej 6 muaj deri 5 vjet	Gjobë dhe burgim prej 1 deri në 8 vjet (dobi/humbje >5,000€)	Gjobë dhe burgim prej 3 deri në 12 vjet (dobi/humbje >50,000€)		
426	Mashtrimi në detyrë	Gjobë dhe burgim prej 6 muaj deri 5 vjet	Gjobë dhe burgim prej 1 deri në 8 vjet (dobi >5,000€)	Gjobë dhe burgim prej 3 deri në 12 vjet (dobi >50,000€)		
427	Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	Gjobë ose burgim deri në 3 vjet				
428	Marrja e ryshfetit	Gjobë dhe burgim prej 6 muaj deri 5 vjet (ne pajtim me detyrat e tij)	Gjobë dhe burgim prej 3 deri 12 vjet (ne kundërshtim me detyrat e tij)	Gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet (demi >15,000, parag. 1)		

Neni	Emërtimi i plotë	Dënimi sipas par. 1	Dënimi sipas par. 2	Dënimi sipas par. 3	Dënimi sipas par. 4	Dënimi sipas par. 5
429	Dhënia e ryshfetit	Gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.	Gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.	Gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. (dobi >15,000€)		
430	Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj	Gjobë dhe burgim deri 5 vjet	Gjobë dhe burgim prej 1 deri 5 vjet	Gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. (dobi >15,000€)		
431	Ushtrimi i ndikimit	Gjobë ose burgim deri në 8 vjet	Gjobë ose burgim deri në 5 vjet	-		
432	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	Burgim gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet	.			
433	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	Gjobë ose burgim deri në 5 vjet	Gjobë dhe burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet	Gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet (pakujdesia)		
434	Falsifikimi i dokumentit zyrtar	Burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.	Burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.			
435	Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme	Gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.	burgim deri në 3 vite (dobi >15,000€) .			
436	Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor	Burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet				
437	Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë	Gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet	Gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.			

Një ndër problemet që ende shfaqet në gjykimin e këtyre veprave penale është vështirësia për të provuar qëllimin e kryerjes së veprës penale. Shumë raste janë pushuar pasi prokurori ka pasur vështirësi të provojë ekzistencën e qëllimit, si element subjektiv, të kryerjes së veprës penale nga ana e të pandehurit.

Në anën tjetër, Kodi i Procedurës Penale,⁶ në nenin 22, ka përcaktuar se cilat vepra penale konsiderohen si krime të rënda për qëllimet e këtij Kodi. Në këtë nen janë përfshirë edhe një sërë veprash me karakter korruptiv, si keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, konflikti i interesit, mashtrimi në detyrë, marrja e ryshfetit, dhe vepra të tjera të ngjashme. Kjo ka bërë që shumica e veprave të parashikuara në Kapitullin XXXIV – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare – të trajtohen si krime të rënda dhe të gjykohen nga Departamenti për Krime të Rënda.

Megjithatë, Kodi i Procedurës Penale nuk e ka përfshirë mosdeklarimin ose deklarimin e rremë të pasurisë si një nga veprat që trajtohen si krime të rënda. Për pasojë, këto raste nuk shqyrtohen nga Departamenti për Krime të Rënda, por nga departamentet e përgjithshme të prokurorive themelore dhe të gjykatave dhe si pasojë trajtohen nga një gjyqtar i vetëm. Për këtë arsye, këto raste nuk gëzojnë prioritetin dhe trajtimin e veçantë që kanë veprat tjera të korrupsionit që hyjnë në kategorinë e krimeve të rënda.

Trajnimet për forcimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit

Gjatë periudhës 2015–2019, institucionet e drejtësisë në Kosovë, në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë, përmes Akademisë së Drejtësisë kanë organizuar një sërë trajnimesh me synim forcimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në luftën kundër korrupsionit dhe krimeve të ndërlidhura. Temat e përzgjedhura për këto trajnime kanë reflektuar nevojat praktike të sistemit të drejtësisë, duke mbuluar aspekte kyçe që nga hetimi i krimeve financiare e deri te prokurimi publik, deklarimi i pasurisë, standardet ndërkombëtare të luftës kundër korrupsionit, si dhe përmirësimi i teknikave të hetimit.

Këto trajnime kanë qenë të strukturuar si në formë të moduleve të specializuara, ashtu edhe si punëtori praktike, me pjesëmarrje të vazhdueshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga të gjitha nivelet. Lista e mëposhtme përmbledh temat kryesore të trajnimeve të mbajtura gjatë kësaj periudhe, duke paraqitur një pamje të qartë të fokusit institucional për ngritjen e kapaciteteve në fushën e parandalimit dhe ndjekjes së korrupsionit.

6 [Kodi Nr. 04/L-123 i Procedures Penale](#), i shfuqizuar

Gjate kësaj periudhe, Akademia e Drejtësisë ka organizuar këto module trajnimi:

- Praktikat e suksesshme në luftimin e korrupsionit
- Hetimi i krimeve financiare / Hetimi financiar / Hetimet financiare / Program i hetimeve financiare – trajnimi 1-rë
- Veprat penale kundër detyrës zyrtare
- Prokurimi publik dhe mundësitë për luftim të korrupsionit
- Standardet e BE-së kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit
- Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës – Sesioni I
- Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës – Sesioni II
- Program i Specializuar Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit – Sesioni I
- Krimi i organizuar dhe korrupsioni
- Program i Specializuar Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën Kundër Korrupsionit – Sesioni II
- Program i Specializuar Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën Kundër Korrupsionit – Sesioni III
- Dështimi Për Deklarim Të Pasurisë Hetimi & Ndjekja
- Korrupsionin, teknikat e hetimit
- Forcimi i kapaciteteve të hetimit penal kundër korrupsionit, me partnerë të drejtësisë penale - me fokus regjioni i Mitrovicës
- Kontratat nga Prokurimi Publik
- Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare
- Procedurat e prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës në veçanti kontestet me OSHP-në

Gjatë vitit 2015 janë organizuar 11 module trajnimi, ku kanë marrë pjesë gjithsej 122 pjesëmarrës, nga të cilët 54 gjyqtarë dhe 68 prokurorë. Temat kryesore kanë përfshirë luftimin e korrupsionit, hetimin e krimeve financiare, veprat kundër detyrës zyrtare, standardet e BE-së kundër krimit të organizuar, si dhe programet e specializuara për prokurimin publik dhe zhvillimin e kapaciteteve kundër korrupsionit.

Në vitin 2016 janë mbajtur 9 trajnime, me një pjesëmarrje të përgjithshme prej 190 pjesëmarrësish, përkatësisht 92 gjyqtarë dhe 98 prokurorë. Trajnimet janë fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve për hetimin dhe ndjekjen e pasurisë, deklarin e pasurisë, si dhe temat e përhershme të prokurimit publik dhe luftës kundër korrupsionit.

Në vitin 2017 janë organizuar 9 trajnime me gjithsej 121 pjesëmarrës, prej të cilëve 77 gjyqtarë dhe 44 prokurorë. Temat e trajtuara kanë përfshirë kryesisht zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit, hetimet financiare, prokurimin publik dhe teknikat e avancuara të hetimit.

Në vitin 2018 janë mbajtur 9 trajnime, në të cilat kanë marrë pjesë 147 pjesëmarrës, nga ta 95 gjyqtarë dhe 52 prokurorë. Fokus kryesor kanë qenë hetimet financiare, forcimi i kapaciteteve të hetimit penal, temat që lidhen me prokurimin publik si dhe trajnime të specializuara për korrupsionin zyrtar.

Gjatë vitit 2019 janë organizuar gjithsej 7 trajnime, ku kanë marrë pjesë 85 pjesëmarrës, prej tyre 51 gjyqtarë dhe 34 prokurorë. Trajnimet kanë përfshirë temat e hetimeve financiare, procedurat e prokurimit, trajnime të avancuara për kapacitetet në luftën kundër korrupsionit dhe çështje të lidhura me kontestet në OSHP.

Viti	Trajnime			Total
		Gjyqtarë	Prokurorë	
2015	11	54	68	 122
2016	9	92	98	 190
2017	9	77	44	 121
2018	9	95	52	 147
2019	7	51	34	 85

Megjithëse numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të trajnuar gjatë periudhës 2015–2019 ka qenë dukshëm i lartë (369 gjyqtarë dhe 296 prokurorë), rezultatet në rritjen e performancës institucionale në luftën kundër korrupsionit nuk kanë qenë në nivelin e pritshëm. Kjo tregon se pjesëmarrja e gjerë në trajnime nuk është shoqëruar domosdoshmërisht me përmirësim të dukshëm të praktikës profesionale apo të efikasitetit në trajtimin e rasteve të korrupsionit.

Disa prej arsyeve të mundshme për këtë mospërputhje mund të lidhen me:

- I. Mungesën e ndërlidhjes praktike ndërmjet trajnimeve dhe punës reale të përditshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- II. Faktin që trajnimi është trajtuar më shumë si detyrim formal, sesa si proces që kërkon reflektim, vlerësim të vazhdueshëm dhe ndjekje të rezultateve konkrete në praktikë.
- III. Mungesën e vlerësimit të nevojave individuale të pjesëmarrësve dhe përshtatjes së moduleve të trajnimit për të adresuar boshllëqet reale të kompetencave profesionale.
- IV. Shpesh temat janë përsëritur çdo vit, por pa analizë të ndikimit të tyre në punën konkrete gjyqësore apo prokuroriale, gjë që mund të ketë sjellë edhe lodhje apo mungesë motivimi të pjesëmarrësit.

Në fund, kjo situatë tregon se investimi në trajnime duhet të shoqërohet me reforma të tjera mbështetëse, si forcimi i mbikëqyrjes së brendshme, vlerësimi i vazhdueshëm i performancës dhe përmirësimi i mekanizmave të llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.

Performanca e sistemit prokurorial

Vlerësimi i efikasitetit të prokurorive në trajtimin e rasteve të korrupsionit për periudhën 2015–2019 tregon një situatë komplekse ku kapacitetet institucionale, cilësia e kallëzimeve penale dhe strategjitë hetimore ndikojnë drejtpërdrejt në rezultatet përfundimtare. Të dhënat e mbledhura nga të gjitha Prokuroritë Themelore dhe PSRK ofrojnë një pasqyrë krahasuese të qartë për performancën dhe rezultatet e secilës prokurori në këtë fushë të ndjeshme dhe me interes publik të lartë.

Është e rëndësishme të theksohet se aktakuzat e ngritura në një vit të caktuar nuk bazohen gjithmonë në kallëzimet penale të paraqitura po atë vit, pasi hetimet zakonisht zgjasin më shumë se një vit. Për shembull, shumë prej aktakuzave të ngritura në vitin 2019 mund të lidhen me kallëzime penale të dorëzuara në vitin 2015 ose 2016 dhe pasqyrojnë kohën e nevojshme për hetim dhe vendimmarrje lidhur me akuzat.

Sipas Udhëzimit për Veprat e Korrupsionit të Profilit të Lartë, miratuar në vitin 2013, të gjitha rastet e korrupsionit të profilit të lartë janë kompetencë e PSRK, e cila është përgjegjëse për trajtimin e rasteve që përfshijnë zyrtarë të lartë publikë, zyrtarë të nivelit qendror dhe lokal, apo raste me ndikim të madh financiar dhe institucional. Për rrjedhojë, të gjitha lëndët e kësaj prokurorie konsiderohen si raste të profilit të lartë, dhe përbëjnë një segment të veçantë të luftës kundër korrupsionit në vend.

PSRK ka paraqitur një dinamikë të ndryshueshme gjatë kësaj periudhe. Në disa vite, numri i aktakuzave të ngritura nga kjo prokurori ka tejkaluar ndjeshëm numrin e kallëzimeve të pranuar, gjë që sugjeron trajtimin e rasteve të mbetura nga vitet paraprake ose përqendrim në hetime afatgjata e të fokusuara. Megjithatë, kjo qasje nuk ka qenë gjithmonë e qëndrueshme – p.sh. në vitin 2019, pavarësisht rritjes së numrit të kallëzimeve, numri i aktakuzave nga PSRK shënoi rënie. Kjo mund të lidhet me vështirësitë strukturore në hetimin e korrupsionit të nivelit të lartë, por edhe me mungesën e resurseve të mjaftueshme.

Nga ana tjetër, Prokuroritë Themelore kanë mbajtur barrën kryesore të kallëzimeve të pranuar çdo vit. Prokuroria Themelore në Prishtinë ka pasur në mënyrë të vazhdueshme numrin më të lartë të kallëzimeve, çka është në përputhje me shtrirjen gjeografike dhe dendësinë institucionale të këtij rajoni. Megjithatë, niveli i efikasitetit, i matur përmes raportit të aktakuzave ndaj kallëzimeve, ka qenë dukshëm më i ulët në krahasim me PSRK. Në shumë raste, përqindja e kallëzimeve të hedhura dhe hetimeve të pushuara nga Prokuroritë Themelore ka qenë e lartë, duke reflektuar sfida në sigurimin e provave të mjaftueshme, kapacitete të kufizuara hetimore, ose kallëzime që nuk përmbushin standardet minimale ligjore.

Një tendencë tjetër e dukshme është luhatja vjetore në numrin e kallëzimeve të pranuar dhe aktakuzave të ngritura. Për shembull, ndër vite vërehen ulje të ndjeshme në aktakuzat pavarësisht stabilitetit në numrin e kallëzimeve – çka mund të sugjerojë ngarkesë të madhe të prokurorëve, mungesë të bashkëpunimit efektiv me policinë hetimore, apo pengesa procedurale në përfundimin e hetimeve.

Pavarësisht këtyre vështirësive, një pjesë e prokurorive, si ajo në Prizren dhe Pejë, kanë treguar performancë relativisht stabile në raportin mes kallëzimeve dhe aktakuzave, edhe pse me numër më të vogël të përgjithshëm të rasteve. Kjo mund të jetë tregues i selektimit më të kujdesshëm të rasteve për ndjekje ose i bashkëpunimit më të mirë institucional në nivel lokal.

Viti	PSRK Kallëzime (persona)	PSRK Aktakuza	% e aktakuzave ndaj kallëzimeve	Prokuroritë Themelore: Kallëzime (persona)	Prokuroritë Themelore: Aktakuza (persona)	% e aktakuzave ndaj kallëzimeve
2015	52	71	136%	808	372	46%
2016	12	97	808%	426	329	77%
2017	4	18	450%	439	340	77%
2018	7	35	500%	378	216	57%
2019	20	10	50%	399	223	56%

Në vitin 2015, u regjistrua numri më i lartë i kallëzimeve penale në pesëvjeçarin e analizuar (860 gjithsej), nga të cilat PSRK pranoi 52 raste. Pavarësisht kësaj, ajo ngriti 71 aktakuza – një numër që tejkalon dukshëm kallëzimet e pranuar, duke sugjeruar se janë finalizuar raste të mbetura nga vitet e mëparshme. Efikasiteti i saj (raporti i aktakuzave me kallëzime) ishte shumë i lartë. Prokuroritë Themelore, në veçanti Prokuroria Themelore në Prishtinë, përballuan një ngarkesë të lartë me 351 kallëzime, por përqindja e aktakuzave mbeti nën 35%. Numri i lartë i hetimeve të pushuara dhe kallëzimeve të hedhura tregon për sfida në përgatitjen e rasteve ose mungesë provash.

Në vitin 2016 shënohet një rënie të ndjeshme të kallëzimeve (438), por me një numër të ngjashëm të aktakuzave (426). Kjo i atribuohet në masë të madhe Prokurorisë së Prishtinës, e cila vetëm në këtë vit hodhi 291 kallëzime dhe ngriti 158 aktakuza. PSRK ngriti 97 aktakuza nga vetëm 12 kallëzime, duke treguar se shumica e rasteve të përpunuara ishin të bartura. Efikasiteti i saj formal ishte shumë i lartë, por gjithashtu evidentohet mbështetja në lëndë të mëparshme dhe përqendrimi në raste komplekse.

Viti 2017 paraqet një stabilizim në numrin total të kallëzimeve (443), por me rritje të rasteve të pushuara. PSRK kishte vetëm 4 kallëzime të reja dhe ngriti 18 aktakuza – kjo sugjeron përqendrim në një numër shumë të vogël rastesh të reja, ndërkohë që pjesa më e madhe e aktiviteteve ishin të natyrës përmblylëse. Prokuroria Themelore në Prishtinë vijon të jetë më e ngarkuara me 208 kallëzime dhe 122 aktakuza. Përkundër kësaj, ka rritje të numrit të hetimeve të pushuara, çka tregon probleme në mbledhjen e provave apo ndjekjen efektive të kallëzimeve.

Në vitin 2018, të gjitha prokuroritë pranuan më pak raste (385 gjithsej), me një trend në rënie edhe në aktakuza. PSRK pranoi vetëm 7 kallëzime dhe ngriti 35 aktakuza – përqindje sërish shumë e lartë, që tregon për punë të përqendruar në raste të mëparshme. Ndërkohë, Prokuroria Themelore në Prishtinë u përball me një numër disproporcional të hetimeve të pushuara (164), që kalon tej mase numrin e aktakuzave. Prokuroritë tjera shfaqin një nivel të moderuar të efikasitetit, me një rënie të dukshme në trajtimin përfundimtar të rasteve.

Në vitin 2019, numri i kallëzimeve mbeti pothuaj i njëjtë me vitin paraparak (419), por PSRK pati një ulje të dukshme të aktakuzave (vetëm 10). Kjo sugjeron ose mungesë të rasteve të pjekura për procedim penal ose mungesë të përparimit në hetime. Për dallim, Prokuroria Themelore në Prizren dhe Prokuroria Themelore në Pejë treguan një raport më të mirë mes kallëzimeve dhe aktakuzave, edhe pse me shifra modeste. Tendenca për hedhjen e kallëzimeve dhe pushimin e hetimeve mbeti shqetësuese në disa rajone.

Në këtë drejtim duhet theksuar se PSRK ka trajtuar më pak kallëzime penale, por raporti i aktakuzave ndaj kallëzimeve është shpeshherë dukshëm më i lartë, gjë që nënkupton se kallëzimet që arrijnë aty janë më të përpunuara dhe më të bazuara. Gjatë viteve 2016 dhe 2017, PSRK-ja ka ngritur shumë më tepër aktakuza sesa kallëzimet e pranuar, çka mund të tregojë se janë trajtuar kallëzime të bartura nga vitet e mëparshme ose është fokusuar në raste të ndërlikuara, me hetime të zgjatura.

Arsyeja pse është bërë ky krahasim ndërmjet PSRK-së dhe prokurorive të tjera themelore buron nga fakti se, sipas Udhëzimit për Veprat e Korrupsionit të Profilit të Lartë (2013), kompetencë shtesë e PSRK është trajtimi i veprave penale të korrupsionit me profil të lartë dhe ky raport dëshiron të ve theksin se sa është luftuar korrupsioni i nivelit të lartë nga organet e akuzës.

PSRK, edhe pse me vëllim më të vogël lëndësh, shfaq efikasitet më të lartë në rastet që mbyllen me aktakuzë, duke e forcuar rolin e saj si prokurori që prin në çështjet komplekse korruptive. Gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare, PSRK ka pranuar 95 kallëzime penale dhe ka ngritur 231 aktakuza. Kjo sugjeron se një pjesë e rasteve janë transferuar nga prokuroritë themelore pasi hetimet kanë kërkuar trajtim të specializuar.

Ndërkohë, prokuroritë themelore kanë pranuar gjithsej 2,450 kallëzime penale dhe kanë ngritur 1 480 aktakuza. Diferenca më e theksuar vërehet në vitin 2015, kur kallëzimet arritën në 808, duke treguar një ulje të kallëzimeve penale pasi që në vitin 2019 raportohen vetëm 399 kallëzime të paraqitura tek organet ndjekëse.

Raporti mes aktakuzave dhe kallëzimeve në PSRK (231 aktakuza kundrejt 95 kallëzimeve), shumë më i lartë se ai i prokurorive themelore (1 480 aktakuza ndaj 2 450 kallëzimeve) sugjeron se PSRK përqendrohet kryesisht në raste që kanë bazë më të fortë provash, ndërsa prokuroritë themelore, veçanërisht ato me ngarkesë të madhe, shpesh ballafaqohen me kallëzime që nuk e arrijnë prapun për ngritjen e aktakuzës. Për këtë arsye, mënyra si PSRK zgjedh dhe menaxhon rastet mund të shërbejë si shembull për prokuroritë themelore.

Performanca e sistemit gjyqësor

Gjatë viteve 2015-2019, sistemi gjyqësor i Kosovës u përball me të njëjtat sfida që karakterizuan sistemin prokurorial në trajtimin e lëndëve të korrupsionit. Departamentet për Krime të Rënda në gjykatat themelore nuk kishin gjithmonë numrin e mjaftueshëm të gjyqtarëve që plotësonin kushtet ligjore për të shërbyer në panelet prej tre gjyqtarëve me përvojë tre vjeçare, prandaj, u lejua që këto vende të lira të mbuloheshin me gjyqtarë nga departamentet e përgjithshme pavarësisht se nuk kishin përvojën e kërkuar me ligj. Edhe pse kjo zgjidhje nuk u shoqërua me ankesa serioze nga palët, ajo mbeti një masë e përkohshme që ndikoi drejtpërdrejt në ritmin e shqyrtimit të lëndëve.

Përderisa nuk ekzistonte ende një departament i posaçëm gjyqësor për lëndët e PSRK, aktakuzat e PSRK-së vazhduan të shqyrtohen në Departamentet për Krime të Rënda të gjykatave themelore, në varësi të kompetencës territoriale. Kjo e rriti ngarkesën e paneleve, të cilat tashmë kishin kapacitet të kufizuar dhe menaxhonin një spektër të gjerë veprash penale të rënda, përveç atyre të korrupsionit.

Statistikat tregojnë se në vitin 2015 gjykatat kishin 944 lëndë korrupsioni në punë (lëndët e bartura dhe ato të pranuar gjatë vitit) dhe përfunduan vetëm 273, që korrespondon me një shkallë efikasiteti prej 28,9 %; si rezultat, në fund të vitit mbetën 671 lëndë të pazgjidhura. Në 2016, me 929 lëndë gjithsej, u përfunduan 358 dhe ngarkesa me lëndë u ul në 571 dhe shkalla e efikasitetit u përmirësua në 38,5 %. Viti 2017 filloi me 811 lëndë, por u përfunduan 289, duke lënë 539 të papërfunduara dhe duke ulur shkallën e efikasitetit në 35,6 %.

Situata u përsërit në 2018 ku nga 774 lëndë në punë u përmbyllën 256, ndërsa ngarkesa me lëndë arriti në 518 dhe shkalla e efikasitetit ra në 33,1 %, duke dëshmuar se gjykatat po përballeshin me kompleksitet në rritje dhe mungesë burimesh të specializuara. Më në fund, në 2019 numri i lëndëve në punë ra ndjeshëm në 419, kryesisht për shkak të rënies së kallëzimeve të reja, dhe u përfunduan 157 lëndë, duke siguruar një shkallë efikasiteti prej 37,5 % dhe duke e ulur ngarkesën totale në 269 lëndë.

Edhe pse efikasiteti luhatej nga viti në vit, gjykatat nuk arritën të mbyllnin asnjëherë më shumë se 40 % të lëndëve të korrupsionit që kishin në punë. Në praktikë, kjo do të thotë se çdo vit në sistem ka pasur më shumë lëndë në punë lëndë sesa zgjidheshin. Në atë kohe kishte mungesë të gjyqtarëve dhe pa shtimin e gjyqtarëve të specializuar ishte e vështirë të pritej që gjyqësori të arrijë një shkallë efikasiteti që do ta përmbyste trendin për lëndët e prapambetura të korrupsionit.

Viti	Lëndë në punë*	Lëndë të përfunduara	Shkalla e efikasitetit**	Lëndë të mbetura
2015	944	273	28,9 %	671
2016	929	358	38,5 %	571
2017	811	289	35,6 %	539
2018	774	256	33,1 %	518
2019	419	157	37,5 %	269

* "Lëndë në punë" përfshin lëndët e papërfunduara nga viti paraprak plus të gjitha kallëzimet e reja të vitit.

** Shkalla e efikasitetit = (Lëndët e përfunduara ÷ Lëndët në punë) × 100.

Gjatë viteve 2015–2019 rreth gjysma e aktgjykimeve janë dënuese, por vërehet një ulje e konsiderueshme e dënimeve pas vitit 2016. Shifra më e lartë e aktgjykimeve dënuese u regjistrua atë vit, me 163, përpara se kjo vlerë të zbriste në 161 në 2017 dhe 128 në 2018 dhe të përgjysmohej në 91 lëndë në vitin 2019.

Edhe pse pjesa më e madhe e çështjeve të mbyllura vijonte të përfundonte me aktgjykime dënuese, vendimet me burg ishin dukshëm më të pakta se gjobat apo dënimet me kusht, që mbetën zgjedhja më e shpeshtë. Ky trend tregon se, pavarësisht ashpërsisë që pritet për veprat korruptive, gjykatat më shumë ishin të prirë të shqiptonin dënime më të lehta.

Në anën tjetër, aktgjykimet liruese dhe ato refuzuese patën luhatjen më të fortë në vitin 2016, kur numri i tyre u dyfishua krahasuar me 2015. Kjo rritje sugjeron se shumë raste janë dorëzuar në gjykatë pa prova të mjaftueshme. Pas atij viti, si aktgjykimet liruese dhe ato refuzuese ranë, por mbetën më lart se niveli fillestar, gjë që sinjalizon ende dobësi në përgatitjen e çështjeve.

Sistemi duket se ka bërë përmirësim të ndjeshëm në menaxhimin e afateve. Rastet që pushuan për shkak të parashkrimit zbritën nga 20 në 2016 në asnjë rast në 2019, çka dëshmon kontroll më të mirë mbi kalendarin procedural.

Në përmbledhje, periudha pesëvjeçare tregon hapa përpara në disiplinën procedurale, por edhe nevojë për prova më solide dhe politika më të qarta ndëshkimi. Rënia e dënimeve me burg, krahas rritjes fillestare të lirimeve, nënvizon sfidën kryesore: ndërtimin e dosjeve që mbajnë peshë në gjykim dhe përcaktimin e sanksioneve që japin efekt parandalues për korrupsionin.

Sa i përket dënimeve, gjykata u përcjellën me trendët e paraqitura ne tabelën më poshtë.

Viti	Aktgjykime dënuese	Aktgjykime liruese	Aktgjykime refuzuese
2015	128	44	33
2016	163	84	49
2017	161	45	25
2018	128	62	23
2019	91	32	21
TOTAL	671	267	151

Kurse sa i përket aktgjykimeve dënuese, tabela me poshtë praqet nëpër vite llojet e dënimeve:

Viti	Aktgjykim Dënues Me Burg	Aktgjykim Dënues Me Gjobë	Aktgjykim Dënues Me Kusht	Aktgjykim Dënues Tjera
2015	34	40	53	1
2016	54	40	67	2
2017	33	58	70	0
2018	23	46	57	2
2019	30	32	27	2
TOTAL	174	216	274	7

Trendi pesëvjeçar flet për një sistem ku gjobat dhe dënimet me kusht kanë qenë masat dominante gjatë gjithë periudhës, duke treguar prirjen e gjykatave për masa më pak represive. Kjo qasje mund të jetë e arsyeshme për raste korrupsioni me dëm të kufizuar, por mund të mos japë efektin e pritur parandalues në rastet me peshë të lartë publike.

Rritja e aktgjykimeve liruese dhe refuzuese në 2016 mund të jetë indikator i mangësive në hetim dhe në koordinimin mes prokurorisë e policisë. Edhe pse situata u përmirësua gradualisht, shifrat më të larta se ato të vitit 2015 tregojnë se puna për forcimin e provave mbetet ende çështje e hapur.

Në anën procedurale, gjykatat kanë bërë përparim të dukshëm. Parashkrimet u zvogëluan nga njëzet raste në 2016 në zero në 2019, ndërsa transferimet e kompetencës, të cilat dikur vononin proceset, pothuajse u zhdukën. Ky përmirësim tregon disiplinë më të madhe në planifikimin e seancave dhe në vendimmarrjen mbi juridiksionin.

Megjithatë, rënia e përgjithshme e dënimeve pas vitit 2016, pavarësisht se ende ka një ngarkesë të konsiderueshme të lëndëve, ngrre pyetjen nëse po i nënshtrohen kontrollit të kualitetit më fuqishëm rastet që dërgohen me aktakuzë në gjykatë apo nëse po paraqiten më pak raste të reja të gatshme për procedim. Sido që të jetë, sfida kryesore mbetet sigurimi i provave të besueshme dhe një politikë ndëshkuese që gërsheton drejtësinë me efektin parandalues të dënimit.

Konkluzion i periudhës 2015 – 2019

Gjatë periudhës 2015-2019, arkitektura institucionale e drejtësisë penale në Kosovë u përcaktua nga një ndarje funksionesh mes tetë prokurorive, nga të cilat shtatë themelore dhe PSRK dhe shtatë gjykatave themelore, por që mungesa e vijave të qarta të kompetencave dhe burimet e kufizuara bënë që sistemi të funksionojë shpesh nën presion.

Udhëzuesi i vitit 2011 për rastet e profilin të lartë zbuti, por nuk e eliminoi plotësisht mbivendosjen ndërmjet PSRK-së dhe prokurorive themelore, sidomos me atë në Prishtinë, ndërsa në gjykata mbeti boshllëku i mungesës së një departamenti të dedikuar ekskluzivisht për çështjet e PSRK. Këto rrethana strukturore shpjegojnë pjesërisht ngarkesën e lartë të rasteve dhe faktin që, edhe pas pesë vjetësh, panelet gjyqësore në departamentet e krimeve të rënda nuk arritën të mbyllnin më shumë se 40 % të lëndëve që kishin në punë.

Edhe pse vëmendja ndaj parashkrimi të rasteve u ngrit në atë masë sa që në vitin 2019 nuk u regjistrua asnjë parashkrim, në anën tjetër rënia e përgjithshme e dënimeve tregon se ndërtimi i provave mbeten pika të dobëta që ndikojnë drejtpërdrejt në efektin parandalues të drejtësisë penale.

Investimi në trajnime – afro 700 pjesëmarrje (gjyqtarë e prokurorë) të përfshirë në më shumë se 40 module – nuk u përkthye në rritje të dukshme të performancës institucionale. Mungesa e lidhjes midis përmbajtjes së trajnimeve dhe nevojave reale, përsëritja e temave pa vlerësim ndikimi dhe trajtimi i pjesëmarrjes si detyrim formal e zvogëluan efektin praktik të këtij angazhimi. Vetëm kur trajnimet të mbështeten nga mekanizma të qartë monitorimi, nga vlerësimi individual i nevojave dhe nga pasqyrimi i rezultateve në sistemin e vlerësimit të performancës, ato mund të shndërrohen në përfitim të prekshëm për luftën kundër korrupsionit.

Në fund, pavarësisht disa përmirësimeve procedurale dhe uljes së ngarkesës totale me lëndë, efikasiteti i prokurorisë dhe i gjykatave mbetet i brishtë dhe i varur nga një numër faktorësh: burimet njerëzore të specializuara, ndarja e kompetencave, fuqia provuese e kallëzimeve dhe qasja e gjykatave në dënimin e korrupsionit.

Disa prej këtyre mangësive u tentuan të adresohen përmes reformimit të kuadrit ligjor dhe institucional, i cili do të trajtohet në pjesën në vijim.

A vertical red line runs down the left side of the page, featuring five red circular dots of varying sizes. The largest dots are at the top and bottom, with three smaller dots in between.

2020

Pjesa 2:
Periudha
2020 – 2024

2024

Kjo periudhë karakterizohet për disa nisma ligjore që synojnë të adresojnë të metat dhe mangësitë e evidentuara ndër vite në trajtimin e lëndëve të korrupsionit, por jo vetëm. Si rezultat, është themeluar Departamenti Special në Gjykatën Themelore për trajtimin e rasteve të PSRK, është paraparë themelimi i një njësie të veçantë vetëm për PSRK, si dhe është nxjerrë Udhëzuesi për dënimet në rastet e korrupsionit me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore dhe për të siguruar një politikë më të ashpër ndaj lëndëve të korrupsionit.

Për më tepër, janë reviduar edhe Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, të gjitha këto në funksion të avancimit të sistemit të drejtësisë dhe përmirësimit të mënyrës së trajtimit të rasteve të korrupsionit. Këto ndryshime synojnë jo vetëm të rrisin efikasitetin, por edhe të garantojnë më shumë përgjegjësi dhe transparencë në procedurat penale.

Korniza organizative

Periudha tjetër e analizuar në këtë raport përfshin vitet 2020 deri në vitin 2024, duke u përdorur si periudhë krahasuese me periudhën paraprake 2015–2019. Gjatë këtyre pesë viteve, korniza ligjore ka pësuar ndryshime të rëndësishme dhe, si rezultat, janë bërë edhe ndryshime në organizimin institucional të sektorit të drejtësisë.


Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat,⁷ u themelua Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të PSRK në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës, me kompetencë për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Kjo risi adresoi kritikën e vazhdueshme lidhur me mënyrën e trajtimit të rasteve të PSRK, duke mundësuar që këto çështje të trajtohen nga një departament i specializuar brenda sistemit gjyqësor. Në këtë mënyrë, është reduktuar edhe perceptimi i mëhershëm për trajtim preferencial të prokurorëve specialë në raport me gjyqtarët që trajtojnë këto lëndë. Departamenti është funksional që nga viti 2019, fillimisht me gjashtë gjyqtarë dhe më pas me nëntë.

Në të njëjtën kohë, edhe pse me një vonesë prej katër vitesh për shkak të rrethanave të ndryshme, ka hyrë në fuqi Ligji për Prokurorinë Speciale,⁸ i cili sjell dy risi kryesore, të cilat ende nuk kanë prodhuar efektin e plotë të pritshëm:

⁷ [Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat](#)

⁸ [Ligji Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale](#)

Strukture organizative e sistemit prokurorial dhe gjyqësor



1. Përcaktimi ligjor i korrupsionit të nivelit të lartë, përmes listimit të qartë të subjekteve që konsiderohen si të tilla, duke përfshirë:
 - Presidentin e Republikës së Kosovës;
 - Kryetarin ose deputetët e Kuvendit të Kosovës;
 - Kryeministrin, zëvendëskryeministrat, ministrat ose zëvendësministrat;
 - Kryetarët e komunave;
 - Gjyqtarët;
 - Prokurorët;
 - Avokatin e Popullit;
 - Guvernatorin e Bankës Qendrore;
 - Drejtorin e Policisë së Kosovës;
 - Drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
 - Auditorin e Përgjithshëm;
 - Drejtorët e Përgjithshëm të Doganave dhe Administratës Tatimore;
 - Zyrtarët kryesorë administrativë, financiarë dhe udhëheqës të prokurimit në të gjitha institucionet publike;
 - Kryeshefat ekzekutivë të ndërmarrjeve publike dhe të agjencive të pavarura.
2. Themelimi i Njesisë së Veçantë të Hetimeve në kuadër të Policisë së Kosovës, me qëllim që të ofrojë mbështetje PSRK për veprime hetimore lidhur me rastet e korrupsionit zyrtar, veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe krimit të organizuar.

Për dallim nga Udhëzuesi për Rastet e Profilit të Lartë të Korrupsionit i vitit 2013,⁹ legjislacioni i ri ka zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme listën e funksioneve publike dhe pozitave që trajtohen si korrupsion i nivelit të lartë. Më parë, disa prej këtyre pozitave janë përfshirë në këtë kategori vetëm në rastet kur dëmi ekonomik ka qenë mbi 500,000 euro, ndërsa me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, ky kriter nuk është më i domosdoshëm. Tani, në këtë kategori hyjnë edhe zyrtarët kryesorë administrativë, financiarë dhe udhëheqës të prokurimit në të gjitha institucionet publike e që më herët PSRK është përballur me sfida për t'i ndjekur penalisht disa nga këto kategori për shkak të kufizimeve në kompetencë.

Po ashtu, zgjerimi i kompetencave të PSRK për trajtimin e lëndëve të korrupsionit, bashkë me asistimin e pritur nga Njësia e re e Policisë, kërkon që kjo njësi të ketë numër të mjaftueshëm të zyrtarëve policorë për të përballuar rritjen e pritshme të rasteve që bien në kompetencë të saj. Në praktikë, kapacitetet aktuale të Policisë së Kosovës nuk i përmbushin këto kërkesa, duke reflektuar edhe mungesën e funksionalizimit të plotë të Njesisë së Veçantë të Hetimeve.

Edhe pse këto nisma reformuese kanë synuar adresimin e mangësive të identifikuar më herët dhe janë ndërmarrë me qëllime të qarta për përmirësim, Njësia e Veçantë e Hetimeve në Policinë e Kosovës vazhdon të mos jetë funksionale, duke mbetur një hallkë e pazëvendësueshme në zinxhirin e luftës kundër veprave penale të natyrës korruptive.

9 Udhëzuesi për Rastet e Profilit të Lartë të Korrupsionit, 2013, [A.-190-2013-Udhezim-Veprat-E-Korrupsionit-Te-Nivelit-Te-Larte.Pdf](#)

Korniza ligjore

Kodi Penal nr. 06/L-074 dhe Kodi i Procedurës Penale 08/L-032

Kodi i ri penal i Kosovës,¹⁰ në thelb, ruan strukturën bazë të dispozitave që lidhen me korrupsionin dhe veprat kundër detyrës zyrtare. Të gjitha veprat kryesore si keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, përvetësimi në detyrë, marrja dhe dhënia e ryshfetit, konflikti i interesit, falsifikimi i dokumenteve zyrtare dhe mosraportimi i pasurisë, vazhdojnë të jenë të parashikuara dhe të kategorizuara si më parë. Kjo bën që logjika dhe renditja e veprave kryesore të mbetet e njohur për praktikuesit e drejtësisë, duke siguruar vazhdimësi në qasjen ndaj luftës kundër korrupsionit.

Ky kod përcakton saktë natyrën e veprës penale, kufijtë e dënimeve dhe elementet themelore që duhet të vërtetohen për përgjegjësinë penale. Dispozitat janë të strukturuar në mënyrë të tillë që të reflektojnë standardet moderne të së drejtës penale dhe të sigurojnë harmoni me parimet ndërkombëtare dhe direktivat relevante të BE-së.

Një risi e rëndësishme është përfshirja e veprës “Mashtrimi në prokurimin publik”, e cila nuk ka qenë e parashikuar në kodin e vjetër penal. Kjo dispozitë ka ardhur si përgjigje ndaj nevojës për të adresuar më qartë rastet e keqpërdorimeve të fondeve publike përmes prokurimit, një fushë ku janë evidentuar sfida të mëdha me korrupsionin në praktikën e institucioneve publike. Përfshirja e kësaj vepre tregon një qasje më të drejtpërdrejtë të ligjvënësit për të parandaluar abuzimet në menaxhimin e kontratave publike dhe për të përmirësuar transparencën në shpenzimet e buxhetit të shtetit.

Po ashtu risi e Kodit të ri Penal është se dënimet për këto vepra janë më të ashpra dhe variojnë sipas natyrës dhe pasojave të tyre, nga gjoba dhe burgimi me afat të shkurtër për shkelje të lehta, deri në dënime të gjata me burg për raste të rënda ku ka dëme të mëdha materiale ose përfitime të konsiderueshme. Për shembull, për keqpërdorimin e pozitës zyrtare, dënimet fillojnë nga gjashtë (6) muaj burgim dhe shkojnë deri në 10 (dhjetë) vite, varësisht nga pasojat e shkaktuara dhe vlera e përfitimit material. Dispozita të veçanta janë parashikuar për raste kur vepra penale përfshin vlera të larta ose dëm të veçantë publik.

Edhe me tutje, në praktikën gjyqësore, nenet që lidhen me keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe ryshfetin mbeten ndër më të përdorurat, veçanërisht në rastet që lidhen me prokurimin publik, administratën shtetërore apo menaxhimin e ndërmarrjeve publike. Ndërkohë, konfliktet e interesit dhe mosdeklarimi i pasurisë vazhdojnë të mbeten sfida si në aspektin e provueshmërisë, ashtu edhe në interpretimin e dispozitave.

10 [Kodi Penal Nr. 06/L-074 i Republikës Së Kosovës](#)

Tabela - Dënimet kryesore nga Kapitulli XXXIV "Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare"

Neni	Emërtimi i plotë	Dënimi sipas par. 1	Dënimi sipas par. 2	Dënimi sipas par. 3	Dënimi sipas par. 4	Dënimi sipas par. 5
Neni	Emërtimi i plotë	Dënimi sipas par. 1	Dënimi sipas par. 2	Dënimi sipas par. 3	Dënimi sipas par. 4	Dënimi sipas par. 5
414	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet	Gjobë dhe burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet (dobi/dëm >5,000€)			
415	Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik	gjobë dhe burgim deri në pesë (5) vjet.	gjobë dhe burgim deri në pesë (5) vjet.	Gjobë dhe burgim prej 1 deri në 8 vjet. (dobi/dëm >5,000€)		
416	Keqpërdorimi i informatës zyrtare	Gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.	Gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet	Gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.	Gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.	
417	Konflikti i interesit	gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet	Burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet (prokurim publik)			
418	Përvetësimi në detyrë	gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet	gjobë dhe burgim 1 – 8 vjet (dobi >5,000€)	gjobë dhe burgim 3 – 12 vjet (dobi >50,000€)		
419	Mashtrimi në detyrë	gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.	gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet	gjobë dhe burgim 1 – 8 vjet (dobi >5,000€)	gjobë dhe 3 – 12 vjet (dobi >50,000€)	
420	Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet				
421	Marrja e ryshfetit	gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.	gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.	gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) (dobi >15,000€)		

Neni	Emërtimi i plotë	Dënimi sipas par. 1	Dënimi sipas par. 2	Dënimi sipas par. 3	Dënimi sipas par. 4	Dënimi sipas par. 5
422	Dhënia e ryshfetit	gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet	gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet	gjobë dhe burgim 1 – 8 vjet (dobi >15,000€)		
423	Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar	gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet	gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet	gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet (dobi >15,000€)		
424	Ushtrimi i ndikimit	gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet	gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tetë (8) vjet			
425	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet				
426	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.	gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet	gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet (pakujdesia)		
427	Falsifikimi i dokumentit zyrtar	burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet	burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet			
428	Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme	gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet	burgim deri në tre (3) vjet (dobi >15,000€)			
429	Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor	burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet				
430	Mos raportimi ose raportimi i remë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare	gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet	gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet			

Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale¹¹ përcakton rregullat e procedurës penale që zbatohen për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e këtyre veprave. Nenet përkatëse të këtij kodi përcaktojnë se cilat vepra konsiderohen si krime të rënda dhe duhet të trajtohen nga Departamenti për Krime të Rënda pranë gjykatave themelore. Edhe në këtë kod, një sërë veprash me karakter korruptiv si keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, marrja ose dhënia e ryshfetit, mashtrimi në detyrë, etj., janë të kategorizuara si krime të rënda. Si rezultat, këto lëndë trajtohen nga panele të përbëra prej tre gjyqtarësh profesionalë, duke reflektuar rëndësinë dhe ndjeshmërinë e tyre për rendin publik dhe integritetin institucional.

Megjithatë, edhe me kodin e ri të procedurës, vepra e mosdeklarimit ose deklarimit të rremë të pasurisë nuk është e përfshirë si vepër që trajtohet si krim i rëndë. Për pasojë, këto raste trajtohen nga departamentet e përgjithshme dhe zakonisht gjykohen nga një gjyqtar i vetëm, pa prioritetin apo mbikëqyrjen e departamentit për krime të rënda.

Udhëzues i veçantë i Gjykatës Supreme: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

Udhëzuesi i veçantë në lidhje me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare¹² është nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës në qershor të vitit 2021, me qëllim që të japë udhëzime të detajuara dhe të standardizuara për gjyqtarët dhe prokurorët lidhur me trajtimin e veprave penale të korrupsionit dhe shkeljeve të detyrës zyrtare.

Nevoja për këtë Udhëzues ka dalë nga vështirësitë që hasen në praktikë gjatë hetimit dhe gjykimin të këtyre veprave, sidomos për shkak të natyrës së fshehtë të korrupsionit dhe mungesës së viktimave të qarta. Për këtë qëllim, edhe pse qëllimi i Udhëzuesit ka qenë unifikimi i politikës ndëshkimore, përmes këtij udhëzuesi është synuar të qartësohen edhe elementet kryesore që duhen vërtetuar për secilën vepër penale, si dhe të jepen kritere për mënyrën e matjes së dënimeve dhe përdorimin e dënimeve plotësuese.

Dokumenti rregullon çështje që lidhen me përcaktimin e personit zyrtar si dhe dashjen dhe mënyrën e provimit të këtyre elementeve, si dhe faktorët që merren parasysh në caktimin e dënimit e që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale dhe dëmin, respektivisht dobinë. Për personin zyrtar, theksohet që ky status përcaktohet jo vetëm nga pozita formale, por edhe nga ushtrimi faktik i detyrave publike, ndërsa për dashjen sqarohet që duhet të jetë e pranishme në shumicën e veprave të korrupsionit, duke u provuar shpesh edhe përmes rrethanave faktike. Në këtë mënyrë, udhëzuesi synon të sjellë praktikë më të njëtrajtshme dhe të rrisë efektivitetin në luftimin e korrupsionit.

Në Udhëzues është sqaruar që vlerësimi i nivelit të fajësisë dhe i dëmit apo dobisë së shkaktuar nga vepra janë dy shtylla kryesore që duhen marrë parasysh gjatë caktimit të dënimit për veprat penale të korrupsionit dhe kundër detyrës zyrtare.

¹¹ Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale

¹² Udhëzuesi i veçantë në lidhje me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, 2021, [98248_Udhezuesi_për_Veprat_e_Korrupsionit-10_Qershor_2021.Pdf](#)

Sa i përket nivelit të fajësisë, gjykata duhet të shikojë se sa i vetëdijshëm dhe me sa qëllim ka vepruar personi zyrtar. Vlerësohet nëse veprimi është bërë me dashje të plotë, me dijeni të rrethanave dhe pasojave, apo nëse është ndikuar nga rrethana lehtësuese siç janë presioni nga eprorët, mungesa e përvojës ose ndonjë faktor tjetër që mund të ulë nivelin e përgjegjësisë. Për veprat e korrupsionit, zakonisht kërkohet dashje dhe qëllim i qartë për të përfituar ose për t'i shkaktuar dëm dikujt tjetër.

Për dëmin ose dobinë, udhëzuesi kërkon që të matet qartë sa është dëmtuar interesi publik, personi apo institucioni, apo sa është përfituar në mënyrë të padrejtë nga kryesi i veprës. Dëmi mund të jetë ekonomik, reputacional apo ndikim negativ në funksionimin e institucioneve publike. Në anën tjetër, përfitimi (dobia) mund të përfshijë pasurim të kundërligjshëm, avantazh të padrejtë apo ndonjë përfitim tjetër material ose jomaterial.

Sipas Udhëzuesit, sa më i lartë të jetë niveli i dashjes dhe qëllimit kriminal, dhe sa më i madh të jetë dëmi apo përfitimi i paligjshëm, aq më i rëndë duhet të konsiderohet vepra dhe aq më i lartë pritët të jetë dënimi. Po ashtu, nëse dëmi apo dobia janë të vogla ose kryesi ka rol më të vogël, këto rrethana mund të ndikojnë në uljen e dënimit.

Pra, gjykata duhet gjithmonë të vlerësojë të dy elementet – si është kryer vepra (fajësia/dashja) dhe sa ka dëmtuar apo përfituar personi apo pala tjetër nga ajo vepër, në mënyrë që dënimi të jetë i drejtë dhe proporcional me rastin.

Si ilustrim është marrë tabela nga Udhëzuesi në lidhje me nenin 414, paragrafi 1 i Kodit Penal – Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, ku parashihet dënimi nga 1 deri në 8 vjet burgim, pavarësisht shumës së dëmit të shkaktuar apo dobisë së fituar përmes veprës penale. Kjo do të thotë që ligji ka caktuar një kornizë të gjerë dënimi, pa marrë parasysh vlerën konkrete të dëmit ose dobisë, ndërsa udhëzuesi ndihmon që dënimi të përcaktohet më drejt dhe më proporcional, duke u bazuar në nivelin e përgjegjësisë së kryesit dhe masën e dëmit apo përfitimit që është shkaktuar në rastin konkret.

	PËRGJEGJËSIA		
DËMI:	LARTË	MESME	ULËT
Deri në 1000 EUR	3-5 vite	2-3 vite	1-2 vite
1000 – 2500 EUR	5-7 vite	3-5 vite	2-3 vite
2500 – 5000 EUR	7-8 vite	5-7 vite	3-5 vite

Në praktikë, kjo nënkupton se edhe për raste me dëm të vogël, dënimi mund të jetë më i ashpër nëse përgjegjësia e zyrtarit është e lartë, dhe anasjelltas, dënimi mund të jetë më i ulët nëse roli i zyrtarit ka qenë më i vogël apo ndikimi i veprës ka qenë i kufizuar, por gjithmonë brenda kufijve të paraparë nga ligji. Kjo qasje synon të sigurojë trajtim më të barabartë dhe të parashikueshëm të rasteve të keqpërdorimit të pozitës zyrtare.

Ndërsa paragrafi 2 i nenit 414 parasheh që nëse dobia apo dëmi i shkaktuar është mbi 5,000 euro, atëherë dënimi bëhet më i ashpër dhe përcaktohet nga 3 deri në 10 vjet burgim. Kjo dispozitë synon që rastet ku dëmi apo përfitimi është i konsiderueshëm të ndëshkohen më rëndë, duke reflektuar seriozitetin më të madh të pasojave të veprës penale.

	PËRGJEGJËSIA		
DËMI:	LARTË	MESME	ULËT
Ulët	5-6 vite	4-5 vite	3-4 vite
Mesme	7-8 vite	5-6 vite	4-5 vite
Lartë	9-10 vite	7-8 vite	5-6 vite

Kjo do të thotë që, nëse një zyrtar i thjeshtë shkakton dëm apo përfiton dobi mbi 5,000 euro, nuk mund të dënohet nën 3 vite burg. Megjithatë, në praktikë shpesh ndodh që kjo politikë ndëshkuese të mos zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme dhe mund të ketë raste kur udhëzuesi anashkalohet ose nuk merret parasysh sa duhet. Edhe pse ligjërisht ky udhëzues nuk është detyrues, fakti që është nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës duhet të kishte peshë të madhe dhe të shërbente si orientim i qartë për të gjithë gjyqtarët, në mënyrë që dënimet për këto vepra të mos jenë arbitrare apo të pavend.

Trajnimet për forcimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit

Edhe gjatë periudhës 2020–2024, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të ofrojë programe trajnimi dhe zhvillimi të kapaciteteve për gjyqtarët dhe prokurorët me fokus në luftimin e korrupsionit dhe krimeve të ndërlidhura. Këto trajnime janë organizuar në mënyrë të vazhdueshme, duke reflektuar nevojat aktuale të sistemit të drejtësisë dhe përpjekjet për të adresuar sfidat praktike në parandalimin dhe ndjekjen e korrupsionit. Pjesëmarrja e lartë nga të gjitha nivelet institucionale dëshmon përkushtimin për ngritjen profesionale të stafit gjyqësor dhe prokurorial në përputhje me standardet më të mira vendore dhe ndërkombëtare.


Gjatë vitit 2020 janë organizuar gjithsej 8 module trajnimi, ku kanë marrë pjesë 156 pjesëmarrës, prej tyre 94 gjyqtarë dhe 62 prokurorë. Temat kanë përfshirë krimin e organizuar dhe korrupsionin, hetimet financiare, prokurimin publik dhe avancimin e procedurave për konfiskimin e pasurisë së paligjshme.

Në vitin 2021 janë mbajtur 6 module trajnimi, me pjesëmarrje shumë të lartë – gjithsej 260 pjesëmarrës, përkatësisht 200 gjyqtarë dhe 60 prokurorë. Ky vit karakterizohet nga një fokus i shtuar te veprat penale kundër detyrës zyrtare, mashtrimi dhe korrupsioni në prokurim publik, si dhe sesione të specializuara për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Rritja e pjesëmarrjes veçanërisht nga gjyqtarët tregon interes dhe nevojë të vazhdueshme për fuqizimin e kapaciteteve në këtë fushë.

Gjatë vitit 2022 janë organizuar gjithsej 10 module trajnimi me 164 pjesëmarrës – 100 gjyqtarë dhe 64 prokurorë. Temat e trajnimeve kanë qenë të larmishme, duke përfshirë mbrojtjen e gjyqtarëve/prokurorëve të përfshirë në rastet e korrupsionit, trajnimet për mashtrimin dhe korrupsionin në prokurim publik, hetimin financiar dhe rikuperimin e aseteve. Vërehet gjithashtu një integritet i elementeve rajonale dhe bashkëpunimit ndërkufitar në trajnime, për të adresuar sfidat e reja në fushën e kthimit të pasurisë.

Në vitin 2023 janë mbajtur 11 module trajnimi, me pjesëmarrje të përgjithshme prej 171 personash, prej tyre 91 gjyqtarë dhe 80 prokurorë. Trajnimet kanë mbuluar gamë të gjerë temash, përfshirë hetimin financiar dhe rikuperimin e aseteve, pastrimin e parave, veprat penale të kryera nëpërmjet prokurimit publik, si dhe temat klasike të korrupsionit zyrtar. Po ashtu, është shtuar përfshirja e prokurorëve në temat e hetimeve financiare, krahas gjyqtarëve që dominojnë temat më të përgjithshme të korrupsionit dhe pasurisë.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar 8 module trajnimi me gjithsej 113 pjesëmarrës, nga të cilët 69 gjyqtarë dhe 44 prokurorë. Vazhdohet të mbizotërojë fokusi në hetimet financiare, rikuperimin e aseteve, pastrimin e parave, korrupsionin zyrtar dhe prokurimin publik, duke reflektuar nevojat dhe sfidat e vazhdueshme të sistemit të drejtësisë në këtë fushë.

Viti	Module trajnimi	 Gjyqtarë	 Prokurorë	Total
2020	8	94	62	 177
2021	6	200	60	 260
2022	10	100	64	 164
2023	11	91	80	 171
2024	8	69	44	 113

Gjatë viteve 2020-2024 Akademia e Drejtësisë organizoi 43 module trajnimi me pjesëmarrje të përgjithshme prej rreth 864 zyrtarësh (554 gjyqtarë dhe 310 prokurorë) – një rritje e dukshme krahasuar me periudhën 2015-2019 (665 pjesëmarrës). Kjo rritje tregon angazhim institucional për ngritjen profesionale, veçanërisht në fushat e hetimeve financiare, rikuperimit të aseteve dhe korrupsionit në prokurim publik.

Megjithatë, të dhënat e performancës për ndjekjen dhe gjykimin e korrupsionit gjatë së njëjtës periudhë nuk pasqyrojnë përmirësim proporcional me shkallën e trajnimeve ku pothuajse në të njëjtat nivele të viteve të kaluara. Kjo do të thotë se sfidat e identifikuara më herët vijnë të jenë të pranishme.

Performanca e sistemit prokurorial

Vitet 2020–2024 përfaqësojnë një fazë ku sistemi prokurorial ka operuar në kontekste të ndryshme sfiduese – përfshirë pandeminë COVID-19, shtimin e presionit publik për rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe ndryshime ligjore që kanë ndikuar në rrjedhën e hetimeve penale. Krahësuar me periudhën 2015–2019, kjo fazë karakterizohet me luhajtje të theksuara në numrin e kallëzimeve penale dhe aktakuzave, me tendencë të përqendrimit të lëndëve në disa prokurori dhe rritje të dukshme në pabarazinë e efikasitetit ndërmjet njësive prokuroriale.

Ashtu si në periudhat e mëparshme, PSRK vazhdon të trajtojë raste të profilit të lartë të korrupsionit, bazuar në Udhëzimin për Veprat e Korrupsionit të Profilit të Lartë të vitit 2013, i cili e përcakton këtë prokurori si institucionin përgjegjës për ndjekjen e rasteve që përfshijnë zyrtarë të lartë, dëme të mëdha financiare apo ndikim të lartë institucional. Kështu, të gjitha rastet e trajtuara nga kjo prokurori në analizë konsiderohen si raste të profilit të lartë.

Viti	PSRK Kallëzime (persona)	PSRK Aktakuza	% e aktakuzave ndaj kallëzimeve	Prokuroritë Themelore: Kallëzime (persona)	Prokuroritë Themelore: Aktakuza (persona)	% e aktakuzave ndaj kallëzimeve
2020	57	51	89.47	322	194	60.25
2021	69	43	62.32	416	305	73.32
2022	57	54	94.74	503	209	41.55
2023	44	24	54.55	586	263	44.88
2024	92	91	98.91	483	203	42.03

Në vitin 2020 PSRK pranoi 57 kallëzime dhe ngriti 51 aktakuza, duke treguar një raport efikasiteti mjaft të lartë (~89%). Krahësuar me vitet paraprake, PSRK kishte një balancë mes lëndëve të reja dhe atyre të përfunduara. Prokuroria Themelore në Prishtinë vazhdoi të përballet me numrin më të madh të kallëzimeve (117), me një nivel të lartë të aktakuzave (95), që përbën një përjashtim pozitiv. Pjesa tjetër e prokurorive ka shifra modeste, por me një përqindje të mirë aktakuzash në raport me kallëzimet.

Në vitin pasues 2021, PSRK përpunoi 69 kallëzime dhe ngriti 43 aktakuza – një rënie në efikasitet krahasuar me vitin paraprak. Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe Mitrovicë tregojnë efikasitet relativisht të lartë, me 139 dhe 50 kallëzime dhe 106 dhe 33 aktakuza përkatësisht. Prokuroria Themelore në Ferizaj ka një përjashtim interesant – numri i aktakuzave (47) është më

i lartë se i kallëzimeve (42), që sugjeron finalizim të rasteve të mbartura. Në përgjithësi, ky vit karakterizohet me nivel më të lartë krahas aktakuzave për të gjitha prokuroritë, duke e bërë një nga vitet më produktive në aspektin e ndjekjes penale.

Në vitin 2022, PSRK ruan një efikasitet shumë të lartë (54 aktakuza nga 57 kallëzime). Megjithatë, Prokuroria Themelore në Prizren, Pejë dhe Gjakovë raportojnë shifra shumë të ulëta të aktakuzave krahasuar me numrin e kallëzimeve – përkatësisht 3, 1 dhe 11, që sugjeron ose mungesë të punës hetimore, ose cilësi të dobët të kallëzimeve. Prokuroria Themelore në Mitrovicë dhe Gjilan shfaqin efikasitet të pranueshëm. Ky vit tregon për një rritje të madhe në numrin total të kallëzimeve (560), por me një performancë të pabarabartë ndërmjet prokurorive.

Në vitin 2023, PSRK ka një rënie të ndjeshme në efikasitet – vetëm 24 aktakuza nga 44 kallëzime. Prokuroria Themelore në Prishtinë shfaq ngarkesë shumë të madhe (288 kallëzime), por vetëm 88 aktakuza, duke reflektuar një përqindje të ulët. Ndërkohë, Prokuroria Themelore në Gjakovë ka raportuar 29 kallëzime dhe 43 aktakuza, që sugjeron mbylljen e rasteve të bartura. Në përgjithësi, efikasiteti i përgjithshëm për vendin është në rënie krahasuar me vitin paraprak, me përjashtime të izoluara.

PSRK ka shënuar performancën më të mirë në pesëvjeçarin e fundit në vitin 2024, me 92 kallëzime dhe 91 aktakuza – efikasitet pothuajse 100%. Kjo tregon qartë se një pjesë e rasteve të grumbulluara janë finalizuar me aktakuza. Prokuroria Themelore në Prishtinë raportoi 192 kallëzime dhe vetëm 59 aktakuza, duke përforcuar idenë se vëllimi i lartë nuk përkthehet automatikisht në efikasitet. Ndërsa Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka raportuar shifra të krahasueshme mes kallëzimeve dhe aktakuzave (43 me 39), që është një tregues pozitiv për efikasitetin rajonal.

Si përfundim, gjatë kësaj periudhe, gjithmonë sipas të dhënave statistikore, PSRK ka mbajtur në mënyrë të qëndrueshme një nivel të lartë efikasiteti në trajtimin e rasteve të korrupsionit, veçanërisht në vitet 2020 dhe 2024, ku përqindja e aktakuzave të ngritura kundrejt kallëzimeve të pranura ka qenë afër ose mbi 90%. Kjo tregon një fokus të vazhdueshëm në trajtimin e rasteve të profilit të lartë dhe një qasje më të konsoliduar në finalizimin e hetimeve me procedim penal.

Ndërkohë, Prokuroria Themelore në Prishtinë përballet çdo vit me numrin më të madh të kallëzimeve penale në rang vendi. Megjithatë, kjo ngarkesë nuk është përcjellë me të njëjtin nivel efikasiteti, pasi përqindja e aktakuzave në raport me kallëzimet mbetet dukshëm më e ulët krahasuar me PSRK. Kjo mund të jetë tregues i sfidave strukturore ose të burimeve të pamjaftueshme për t'i trajtuar në mënyrë efektive të gjitha rastet.

Në disa prokurori, si Peja dhe Prizreni, vërehen përqindje jashtëzakonisht të ulëta të aktakuzave në disa vite, pavarësisht se ngarkesa nuk ka qenë ndër më të lartat. Kjo tregon për nevojën e një analize më të thelluar për të kuptuar faktorët që ndikojnë në performancën e tyre – qofshin ato kapacitete njerëzore, organizimi i brendshëm apo qasje ndaj ndjekjes penale.

Performanca e sistemit gjyqësor

Performanca e sistemit gjyqësor për këtë periudhë do të analizohet në dy pjesë: vitet 2020 dhe 2021, dhe vitet 2022, 2023 dhe 2024, pasi të dhënat që i kemi pranuar nga KGJK për tre vitet e fundit - për periudhën 2022–2024 - paraqesin vështirësi të konsiderueshme në përcaktimin e saktë të llojit të vendimeve apo dënimeve të shqiptuara. Në shumë raste, për çështje që kanë pasur vetëm një të pandehur, janë regjistruar më shumë se një masë ndëshkuese, edhe pse akuza ka qenë për vetëm një vepër penale. Kjo ndërlikon analizën dhe interpretimin e të dhënave. Për më tepër, në rastet kur janë regjistruar më shumë se një masë ndëshkuese, shpesh mungojnë të dhënat për numrin e të pandehurve, çka krijon paqartësi dhe e vështirëson ndjeshëm qartësimin e strukturës së vendimeve gjyqësore përkatëse.

Për më tepër, nuk janë pranuar as të dhëna mbi performancën e Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës, që do të mundësonin analizën e drejtpërdrejt krahas të dhënave të PSRK-së.

Në vitin 2020, përballë kufizimeve të punës në sallë dhe riorganizimit të seancave për shkak të pandemisë, gjykatat kishin në punë 394 lëndë korupsioni. Prej tyre, u arrit të përfundohen vetëm 112. Kjo do të thotë se afërsisht tri të katërtat e punës së atij viti mbetën të papërfunduara, duke çuar ngarkesën me lëndët e pazgjidhura në 282.

Situata nuk ndryshoi ndjeshëm as në 2021 ku numri i lëndëve të korupsionit pësoi një ulje të lehtë në 383, por gjykatat përfunduan vetëm dy raste më pak se vitin paraprak – 108 gjithsej. Numri i lëndëve të prapambetura mbeti gati e pandryshuar, me 275 lëndë që u transferuan në vitin pasues kalendarik. Në praktikë, gjykatat mbyllën më pak se një të tretën e çështjeve që patën në dorë në secilin prej dy viteve.

Viti	Lëndë në punë*	Lëndë të përfunduara	Shkalla e efikasitetit**	Lëndë të mbetura
2020	394	112	28.4%	282
2021	383	108	28.2%	275

Në përbërjen e vendimeve vihet re një ndryshim i vogël në dënimet me burg. Pas një viti 2020 ku u shqiptuan 17 dënime të tilla, 2021-i solli rritjen në 22 dënime me burg. Gjobat, ndërkohë, mbetën masa më e shpeshtë (33 në 2020, 31 në 2021), ndërsa dënimet me kusht ranë nga 13 në 6, çka sinjalizon se gjykatat kanë filluar ta rezervojnë këtë formë sanksioni vetëm për rastet vërtet më të lehta.

Viti	DËNIME ME BURG	ME GJOBË	ME KUSHT	GJITHSEJ DËNIME
2020	17	33	13	63
2021	22	31	6	59

Aktgjykimet liruese dhe refuzuese pësuan rënie. Aktgjykimet liruese zbritën nga 30 në 26, ndërsa refuzimet u përgjysmuan nga 9 në 4. Kjo lë përshtypjen se prokuroritë po ia përcjellin gjykatave raste më të themelta, ose se gjyqësori po filtron më herët problemet procedurale. Edhe çështjet që dikur mbylleshin për shkak të parashkrimit u eliminuan plotësisht ku në të dy vitet nuk u shënua asnjë rast i tillë.

Megjithatë, raporti mes çështjeve të përfunduara dhe atyre që mbeten të papërfunduara nuk lë vend për kënaqësi. Më shumë se shtatë në dhjetë dosje korrupsioni vazhdojnë të qëndrojnë në pritje të vendimit. Nëse nuk shtohen gjyqtarët e specializuar dhe nuk thjeshtohen procedurat për rastet më pak të ndërlikuara, trajektorja e prapambetjes do të mbetet praktikisht e pandryshuar.

Në thelb, vitet 2020 dhe 2021 konfirmuan një realitet të dyfishtë: nga njëra anë, cilësia e aktgjykimeve po përmirësohet, me më shumë dënime burgimi dhe më pak lirime të pabazuara; nga ana tjetër, ritmi i punës mbetet nën kufirin e nevojshëm për të ulur stokun e lëndëve të prapambetura.

Sistemi gjyqësor raportoi shifra të ndryshme për trajtimin e çështjeve të korrupsionit në vitet 2022-2024. Të dhënat zyrtare tregojnë jo vetëm lëvizje të mëdha në numrin e lëndëve të përfunduara, por edhe mospërputhje mes lëndëve të pazgjidhura në fund të një viti dhe atyre që shfaqen si të trashëguara në vitin pasues. Kjo e vështirëson kuptimin e vërtetë të ngarkesës dhe vlerësimin se sa efikas ka qenë gjyqësori në mbylljen e rasteve të korrupsionit.

Viti	Ngarkesa me lëndë (në punë)	Lëndë të përfunduara	Shkalla e përfundimit	Lëndë të pazgjidhura
2022	268	82	30,6 %	184
2023	128	47	36,7 %	72
2024	462	398	86,1 %	64

Për shkak se gjatë përpilimit të këtij raporti këto të dhëna nuk na janë dukur të sakta, po paraqesim edhe tabelën e gjykatave për vitet 2022, 2023 dhe 2024.

Tabela më poshtë jep një pasqyrë më të detajuar.

	Trashëguara	Pranuara	Lëndë në punë	Zgjidhura	Pazgjidhura	
2022	Prishtinë	74	36	110	33	77
	Gjilan	21	27	48	17	31
	Prizren	13	20	33	15	18
	Mitrovicë	31	14	45	6	37
	Gjakovë	5	3	8	3	5
	Pejë	4	8	12	6	6
	Ferizaj	10	2	12	2	10
	GJTHSEJ	158	110	268	82	184
2023	Prishtinë	37	1	38	13	15
	Gjilan	12	6	18	7	11
	Prizren	6	5	11	4	7
	Mitrovicë	27	6	33	11	22
	Gjakovë	13	3	16	6	11
	Pejë	5	3	8	3	5
	Ferizaj	4	0	4	3	1
	GJTHSEJ	104	24	128	47	72
2024	Prishtinë	117	8	125	109	16
	Gjilan	96	3	99	92	7
	Prizren	70	13	83	72	11
	Mitrovicë	41	10	51	38	13
	Gjakovë	17	3	20	19	1
	Pejë	18	4	22	20	2
	Ferizaj	28	4	32	27	5
	Departamenti Special Prishtinë	27	3	30	21	9
	GJTHSEJ	414	48	462	398	64

Në vitin 2022 gjykatat nisën me 268 lëndë korrupsioni dhe arritën të përfundojnë 82, duke lënë 184 të pazgjidhura; gati tre të katërtat e ngarkesës mbetën pezull, kryesisht në Prishtinë dhe Mitrovicë. Në 2023 ngarkesa ra në 128 lëndë, por u mbyllën vetëm 47, kështu që 72 kaluan në vitin pasues – ritmi i përfundimit u përmirësua lehtë, por mbeti larg objektivit për të pakësuar stokun. Viti 2024 doli jashtë parashikimeve: raportohen 462 lëndë në punë dhe 398 të përfunduara, duke e rritur shkallën e përfundimit në 86 %. Kjo rritje e papritur ngre dyshime për mënyrën si janë regjistruar lëndët; 342 raste shtohen në kolonën "trashëguara" pa u reflektuar në shifrat e vitit 2023 dhe 390 lëndë "shtesë" dalin në sipërfaqe brenda një viti.

Ky hendek nënkupton se kolonat "pazgjidhura" të një viti dhe "trashëguara" të vitit pasues nuk komunikojnë si duhet. Pa lidhje të qartë numerike, bëhet e vështirë të kuptohet realisht sa lëndë mbeten pezull dhe sa zgjidhen në çdo vit kalendarik.

Mungesa e lidhjes numerike midis lëndëve të pazgjidhura dhe atyre që shihet si trashëgim vitin tjetër nënkupton rrezik të lartë për planifikim të pasaktë të burimeve, transparencë të cunguar dhe vështirësi për të matur realisht progresin. Pa një verifikim të plotë të regjistrave dhe pa standarde të njëjta raportimi në të gjitha gjykatat, mbetet e paqartë nëse 2024 përfaqëson një sukses real apo thjesht një pastrim statistikash.

Të dhënat e viteve 2022-2024 tregojnë dy anët e medaljes: nga njëra anë, gjykatat arritën të mbyllin një numër rekord lëndësh në 2024 kurse nga ana tjetër, raportimi mbi lëndët e pazgjidhura dhe ato të trashëguara mbetet i paqëndrueshëm.

Derisa kjo mospërputhje nuk mbyllet me verifikim të plotë të regjistrave, nuk mund të dimë me siguri nëse kemi të bëjmë me një përmirësim të vërtetë apo thjesht me një pastrim statistikor. Vetëm një pasqyrë e qartë dhe e standardizuar do t'i mundësojë sistemit gjyqësor të planifikojë burimet siç duhet dhe të fitojë besimin e publikut se rastet e korrupsionit po marrin epilog në kohë.

Konkluzione

Kur krahasojmë periudhën 2015-2019 me 2020-2024, del qartë se ndërhyrjet ligjore i kanë dhënë sistemit një infrastrukturë më të saktë, por rezultatet në terren ecin më ngadalë se dispozitat në letër. Në fazën e parë, ligjet e miratuara më 2013 u zbatuan pa mekanizma të specializuar dhe pa kufij të prerë kompetencash, prandaj prokuroritë themelore bartin shumicën e kallëzimeve por arrinin një raport të kufizuar aktakuzash. Gjyqësori, ndërkohë, operonte me departamente të krimeve të rënda të shpërndara në të shtatë gjykatat themelore, pa një trupë ekskluzive për lëndët e PSRK-së dhe pa numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve me përvojë të caktuar. Kjo strukturë e fragmentuar dhe mungesa e standardeve të përbashkëta në ndëshkim kontribuan në stokun e lartë të çështjeve të pazgjidhura dhe në dënime të buta, kryesisht gjopa apo masa me kusht.

Në periudhën e dytë ligjvënësi vendosi themelet për një trajtim më të centralizuar të korrupsionit të nivelit të lartë: Departamenti Special i Prishtinës mori kompetencë territoriale për rastet e PSRK, Kodi i ri Penal forcoi kornizën ndëshkimore, ndërsa Ligji i ri për PSRK zgjeroi listën e funksionarëve që trajtohen automatikisht si subjekte të korrupsionit të lartë. Gjykata Supreme, me Udhëzuesin e vitit 2021, ofroi udhërrëfyes për matjen e fajësisë dhe dëmit, duke synuar ta bëjë politikën ndëshkimore të krahasueshme nga rasti në rast. PSRK e ka shfrytëzuar këtë konfigurim dhe në vitet 2020 dhe 2024 ngriti aktakuza për afro të gjitha kallëzimet e pranuar. Por efektet në prokuroritë themelore janë më modeste pasi që Prokuroria Themelore në Prishtinë mbetet e tej ngarkuar dhe shpesh nuk arrin të avancojë kallëzimet në aktakuza në masën e dëshiruar, ndërsa Peja dhe Prizreni vazhdojnë të prodhojnë aktakuza simbolike pavarësisht numrit relativisht të vogël rastesh.

Nga ana e gjykatave, departamenti i specializuar ka rritur transparencën procedurale në rastet e PSRK-së, por shifrat e raportuara për vitet 2022-2024 nuk lidhen organikisht me ngarkesën e bartur, gjë që krijon hije dyshimi mbi përmirësimin e publikuar të efikasitetit. Pa një standard unik raportimi dhe pa auditim të jashtëm të statistikave, është e vështirë të matet sa raste mbyllen realisht dhe sa thjesht rindërrohen midis kolonave "trashëguara" dhe "pazgjidhura".

Çka mbetet e pandryshuar gjatë të dy periudhave është dallimi mes numrit të madh trajnimesh dhe ndikimit të tyre në praktikë. Përgjatë dhjetë viteve janë mbajtur mbi tetëdhjetë module, me më shumë se 1,500 pjesëmarrje, por pa një sistem monitorimi që ta lidhë performancën individuale me pjesëmarrjen në trajnim. Derisa mentorimi në vendin e punës dhe vlerësimi i nevojave të bëhen pjesë e rutinës, investimi në kapacitete vazhdon të prodhojë rezultate më tepër nominale sesa substanciale.

Në thelb, Kosova ka bërë një hap të rëndësishëm nga "korniza ligjore formale" drejt "infrastrukturës institucionale të specializuar", por suksesi do të matet vetëm kur Njësia e Veçantë e Hetimeve të bëhet funksionale, kur prokuroritë themelore të kenë resurse të balancuara dhe kur gjykatat të raportojnë të dhëna të verifikuara që e pasqyrojnë saktë ecurinë e çështjeve të korrupsionit. Vetëm atëherë Udhëzuesi i Gjykatës Supreme, Kodet e reformuara dhe Departamenti Special do të përkthehen në ulje të qëndrueshme të korrupsionit dhe rritje të besimit publik në drejtësi.

Rekomandimet

Rekomandimet që vijojnë synojnë të kthejnë gjetjet kryesore të analizës në veprime konkrete, të matshme dhe të realizueshme nga institucionet përgjegjëse. Ato përqendrohen te boshllëqet më të dukshme me synim final që është një sistem drejtësie më i besueshëm, me procese të shpejta, dënime të parashikueshme dhe llogaridhënie reale për zyrtarët publikë.

Funksionalizimi i plotë i Njesisë së Veçantë të Hetimeve

Pa hetues të dedikuar, PSRK detyrohet të mbështetet te struktura të përgjithshme të policisë, gjë që vonon veprimet operative dhe rrjedhimisht ul shanset për grumbullimin e provave cilësore. Njësia e Veçantë, me mandate të qarta, protokolle pune dhe buxhet të veçantë, do të sigurojë reagim më të shpejtë, bashkëpunim më të fortë prokuror-polici dhe unifikim të teknikave hetimore në rastet komplekse të korrupsionit.

Standardizimi dhe auditimi vjetor i statistikave prokuroriale e gjyqësore

Sot formatet e raportimit ndryshojnë nga një institucion te tjetri, duke bërë të pamundur krahasimin korrekt të të dhënave dhe planifikimin efektiv të burimeve. Një metodologji unike, e kontrolluar çdo vit nga një trupë e pavarur, rrit transparencën, i jep besueshmëri publikut dhe lejon menaxhimin proaktiv të stokut të lëndëve.

Rishpërndarja e ngarkesës në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe rritja e stafit mbështetës

Prokuroria Themelore në Prishtinë trajton gati një të tretën e kallëzimeve në nivel vendi, çka krijon vonesa strukturore edhe kur prokurorët janë të motivuar. Shtimi i numrit të prokurorëve, i shoqëruar me shtim të bashkëpunëtorëve profesional dhe kontabilistëve forenzik në Prishtinë, do të sjellte kohën e përfundimit të hetimeve brenda afateve ligjore.

Zbatimi i detyrueshëm i Udhëzuesit të Gjykatës Supreme mbi dënimet

Vendimet gjyqësore për korrupsionin ende ndryshojnë ndjeshëm për raste me rrethana të ngjashme, duke krijuar perceptim të padrejtësisë. Nxjerrja e një Ligj për Politikën Ndëshkimore do ta bëjë referencë detyruese për gjyqtarët, do të kufizojë diskrecionin e tepruar dhe do të rrisë parashikueshmërinë e sanksioneve.

Kategorizimi i mosdeklarimit të pasurisë si krim i rëndë

Kur mosdeklarimi gjykohet në departamentet e përgjithshme, rastet shpesh mbesin prapa listës së prioritetit. Futja e kësaj vepre në listën e krimeve të rënda e transferon automatikisht te panelet prej tre gjyqtarësh dhe krijon efekt më të fortë parandalues, pasi zyrtarët e kuptojnë se çështja trajtohet me të njëjtën peshë si ryshfeti apo keqpërdorimi i detyrës.

Program mentorimi pas trajnimeve, i lidhur me vlerësimin e performancës

Modulet klasike ofrojnë dije teorike, por pa mbështetje praktike ato humbin efektin. Një skemë ku secili pjesëmarrës punon rast konkret nën drejtimin e një mentori dhe më pas raporton rezultatet, siguron transferim real të njohurisë dhe bën që trajnimi të peshojë në vlerësimin vjetor të punonjësit.

Rastet e profilit të lartë me afate fikse

Rastet ku përfshihen zyrtarë të lartë dëmtojnë perceptimin publik për shkaqe të vonesave në përfundimin e këtyre rasteve. Caktimi i një kalendarit për seancat bllok e mban rastin në fokus të gjykatës dhe redukton taktikat e palëve në procedure për ta zvarritur procesin.

Rishikim pesë-vjeçar i kornizës ligjore me kontribut të shoqërisë civile

Mjedisi shoqëror dhe teknologjik ndryshon shpejt dhe dispozitat që sot duken të përshtatshme për aktualitetin mund të bëhen të papërshtatshme pas disa vitesh. Një mekanizëm periodik, me tryeza të hapura për organizatat e shoqërisë civile, juristët, praktikantët dhe akademinë, siguron që ligjet të mbeten të zbatueshme, në përputhje me standardet e BE-së dhe të përqendruara te interesat e qytetarëve.

